



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KLOS

Klos, më . . .2022

PROJEKT VENDIM

Nr. ___ Datë ___ / ___ /2022

PËR DHËNIE MENDIMI PËR FILLIM PROCEDURASH PER DHËNIE NË PËRDORIM
NGA FONDI PYJOR I SIPËRFAQEVE TË KËRKUAR NGA SUBJEKTE PRIVATE.

Mbështetur ne "Ligjin 139/2015" për vetqeverisjen vendore "Neni 54" shkonja "K", në zbatim të ligjit nr. 57/2020, "Për Pyjet" në "V.K.M Nr.591 dt.9.10.2018 për disa ndryshime në vendimin Nr.1353 Datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e rregulloreve për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të Fondit Pyjorë Të ndryshuar në pikën "2." shkonja "Ç" për miratimin me shkrim për vazhdimin e procedurave të dhënies në përdorim me vendim të Këshillit Bashkiak, brenda territorit Administrativ të të cilit është sipërfaqia pyjore e cila do ti nënshtrohet procedurave të dhënies, i kërkojmë këshillit të bashkisë të.

V E N D O S Ë:

1. Miratimin për fillimin e procedurave për dhënie në përdorim të sipërfaqes nga fondi pyjor i kërkuar nga subjekti privat.
 - Subjekti "Mazllëm Çeliku – Person Fizik" me NUIS. L97529901D. Sipërfaqia e kërkuar është 1 ha, në ngastrat nr. 25b dhe 26c. Zona Kadastrale 3460. Përdorimi i sipërfaqes: Veprimtari turistike kampingje.

KRYETARI

Ilmi Hoxha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TE BUJQËSISË DHE PYJEVE
SEKTORI I KËSHILLIMIT DHE SHËRBIMEVE BUJQËSORE, SHËRBIMIT
VETERINAR, ADMINISTRIMIT DHE MONITORIMIT TË PYJEVE

Klos, më . . 2022

RELACION SHPJEGUES

PËR DHËNIEN E MENDIMIT PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE, PËR DHËNIE NË PËRDORIM, TË SIPËRFAQES SË KËRKUAR, NGA SUBJEKTI "MAZLLËM ÇELIKU – PERSON FIZIK" , " PËR VEPRIMTARI TURISTIKE KAMPINGJE", NGA FONDI PYJOR KULLOSOR PËR NJË SIPËRFAQE PREJ 1 ha.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Klos

Të nderuar Këshilltarë,

Ky relacion është hartuar duke u bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe në mbështetje të ligjit 57/ 2020 “ Për Pyjet”, VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit Pyjor”, VKM nr.1064, datë 22.12.2010 e azhornuar, mbi “Përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave”, VKM nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht, në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, Udhëzimi ministrit të Mjedisit nr. 1, datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjorë dhe kullosor publik, Vendimin nr. 1064, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar, si dhe bazuar në kërkesën e ardhur nga subjekti me nr. praktike 7273 prot., datë 04.05.2022, protokolluar në Bashkinë Klos me nr.1162 prot., më datë 04.05.2022 “Për hartimin e raportit tekniko- ekonomik”, “Për veprimtari turistike kampingje”, në vendin e quajtur Ara e Kuqe , të ndodhur në territorin e bashkisë Klos, urdhërin me nr. 76, datë 20.05.2022 të Kryetarit të Bashkisë Klos, për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqeve pyjore/kullosore”, që propozohen të jepen në përdorim për "Veprimtari turistike kampingje". Pas verifikimeve të bëra në terren gjurma që do jepet me qera shtrihet në Ekonominë Pyjore "Balgjaj 2", ngastrat nr. 25b, dhe 26c . Grupi i punës i përbërë nga:

Ing.Kapllan Allamani Specialist i kadastrës pyjore, Alban Hajri Specialist i mesëm pyjesh

dhe Arbër Kuleni specialist i mesëm pyjesh , nga data 23.05.2022 deri me datë 25.05.2022 studioj kërkesën e subjektit "Mazllëm Çeliku – Person Fizik" , realizoi verifikimin në terren dhe regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore e kullosore me objekt: "Veprimtari turistike kampingje".

Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral/kullosor rezulton që sipërfaqja e kërkuar është 1 ha ndarë në: ngastra nr. 25b sipërfaqja = 0.33 ha dhe ngastra nr.26c = 0.67 ha, rruga që do përdorë shoqëria për Veprimtarinë turistike kampingje është rruga Qaf – Dardhë – Balgjaj, rrugë e cila përdoret nga subjekti në fjalë , me NUIS L901D. Sipërfaqja që do jepet me qera sipas VKM-1064 datë 22/12/2010 "Për disa ndryshime në VKM nr. 391 datë 21/06/2006" për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave", Lidhja nr. 2 pika 5, "Përqëlime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe veprimtari turistike kampingje. Çmimishte 1 ha x 75000 = 75000 lekë. Tarifë që do paguhet cdo vit.

Vlera e investimeve të kryera (pyllëzime, zëvendësime, përmirësime) ndër vite është 0 lekë.

Tarifë për dru zjarri $10 \text{ m}^3 \times 500 = 5000$ lekë.

Vlera e faunës është 0 lekë.

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe të akteve të tjera normative sa më sipër, shoqëria kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur, vetëm pas lidhjes së kontratës me Bashkinë Klos dhe likuidimin e tarifës prej **80000 (tetëdhjetë mijë) lekë**. Tarifë vetëm për vitin e parë. Tarifa për vitet pasardhës është 75000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë në vit.

Tarifat e dhënjes në përdorim/heqjes nga fondi pyjor e kullosor bazohet në VKM-nr. 1064, datë 22.12.2010-“Për disa ndryshime në VKM-nr 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e Pyjeve dhe Kullotave”, bazohen në afatet kohore sipas grafikut të punimeve të miratuara nga Institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit.

Duke ju falenderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit.

Specialisti i Kadastrës Pyjore

Ing. Kapllan Allamani

